EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXVI, nr. 8425
E enjte, 5 nëntor 2026
Çmimi 0. 50 €

Si mund të ndikojë fitorja e demokratëve në politikat e Trumpit ndaj Rusisë, Ukrainës dhe Iranit? FAQE 2




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

RAPORTI I BE-së: KOSOVA KA NGECUR NË REFORMAT KYÇE PËR INTEGRIM FAQE 4-5

- Asnjë përparim në gjyqësor, më pak dënime për korrupsion të nivelit të lartë dhe reforma të ngecura





Kosova vazhdon të ngecë në disa nga reformat kryesore që duhet ta afrojnë me Bashkimin Evropian. Gjyqësori nuk ka shënuar asnjë përparim, lufta kundër korrupsionit ka dhënë rezultate të kufizuara, ndërsa krizat politike kanë dobësuar funksionimin e institucioneve. Kjo është tabloja që paraqet Komisioni Evropian në raportin e tij për Kosovën për vitin 2026, ku paralajmëron se ndikimet politike dhe ekonomike në sistemin e drejtësisë mbeten pengesë serioze për pavarësinë e tij dhe, në disa aspekte, madje janë shtuar. Raportin evidenton rënie të numrit të vendimeve përfundimtare dhe dënimeve për korrupsion të nivelit të lartë, gjithashtu edhe mangësi në mbikëqyrjen parlamentare të qeverisë

MBI 4 MILIARDË EURO NË PROJEKTBUXHET: KUSH MERR SA? F. 7



KATËR ORGANIZATA U BËJNË THIRRJE PRINDËRVE T'I VAKSINOJNË FËMIJËT F. 6



RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht -Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · ÇUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 870
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

AKTUALE



SHQIPËRIA KA SHËNUAR PËRPARIM NË ZBATIMIN E REFORMAVE KYÇE F. 5

PROKURORIA SPECIALE JEP HOLLËSI PËR SEKUESTRIMIN E MBI 37 KILOGRAMËVE HEROINË F. 3

MPB DHE POLICIA E KOSOVËS PARAQITËN NË SARAJEVË ARRITJET DHE PRIORITETET NË LUFTIMIN E TERRORIZMIT DHE PARANDALIMIN E EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM F. 6

EKONOMI



KRYETARI I AKB-së, SHAHINI: BUXHET I MADH, ZHVILLIM I PAMJAFTUESHËM F. 8

GUVERNATORI ISMAILI TAKON KURTIN: NË FOKUS PËRGATITJET PËRFUNDIMTARE PËR APLIKIM NË SEPA DHE REFORMAT NË SEKTORIN FINANCIAR F. 8

SPORT



KOSOVA MËSON KUNDËRSHTARET NË EDICIONIN E RI TË LIGËS SË KOMBEVE F. 11

SI MUND TË NDIKOJË FITORJA E DEMOKRATËVE NË POLITIKAT E TRUMPIT NDAJ RUSISË, UKRAINËS DHE IRANIT?

UASHINGTON, 4 NËNTOR - Fitorja e Partisë Demokratike në zgjedhjet e mesmandatit në Shtetet e Bashkuara pritet ta ndryshojë balancën e pushtetit në Kongres, duke i dhënë kësaj partie më shumë kompetenca mbikëqyrëse dhe ndikim në procesin legjislativ. Kjo mund të ketë ndikim edhe në politikat e ShBA-së ndaj Rusisë, Ukrainës dhe Iranit.

Triumfi i demokratëve në zgjedhjet e mbajtura më 3 nëntor pritet t'ua mundësojë atyre marrjen e kontrollit mbi të dyja dhomat e Kongresit, Senatin dhe Dhomën e Përfaqësuesve, nga republikanët e presidentit Donald Trump, sipas projeksioneve të disa mediave të mëdha amerikane.

Rezultati i zgjedhjeve të 3 nëntorit përbën ndryshim të rëndësishëm të balancës së pushtetit në Kongres, duke u dhënë demokratëve më shumë ndikim në vendimet për shpenzimet federale, mbikëqyrjen e administratës dhe konfirmimin e emërimeve presidenciale.

Trump tha se është i gatshëm t'i pranojë rezultatet e zgjedhjeve dhe të bashkëpunojë me demokratët, sipas gazetës The New York Times. "Do të punojmë me demokratët dhe, e dini, mezi presim të bashkëpunojmë me ta. Do t'ia bëjmë disi", citohet të ketë thënë Trump.

Trumpi vazhdon të ketë kompetenca të gjera në fushën e diplomacisë dhe të operacioneve ushtarake, ndërsa kundërshtimi i republikanëve dhe e drejta e tij për veto mund t'i pengojnë demokratët që fitoret në Kongres t'i përkthejnë në ndryshime konkrete ligjore.

Zgjedhjet u mbajtën në një kohë kur Shtetet e Bashkuara dhe Izraeli janë ende në luftë me Iranin, dhe Rusia po e vazhdon pushtimin në shkallë të plotë të Ukrainës, ndërsa qasja e Uashingtonit ndaj Moskës mbetet burim mospajtimesh mes dy partive kryesore amerikane.

Sfida e parë për Kongresin, sa i përket politikës së jashtme, mund të jetë lufta me Iranin.

Demokratët zhvilluan fushatë me zotimin për t'i dhënë fund konfliktit, i cili ka kontribuar në rritjen e çmimeve të energjisë dhe pasigurinë ekonomike. Kontrolli i të dyja dhomave të Kongresit do t'ua rrisë mundësitë për ta mbikëqyrur administratën, për t'i kundërshtuar shpenzimet ushtarake dhe për të kërkuar kufizime në operacionet ushtarake.

Dania Arayssi, drejtuese e programeve dhe analiste e lartë në Institutin Linjat e Reja për Strategji dhe Politika, e cila rregullisht informon vendimmarrësit në Kongres dhe në degën ekzekutive, i tha Radios Evropa e Lirë se rezultatet e zgjedhjeve mund ta shtyjnë Trumpin drejt tërheqjes nga lufta përmes rrugëve diplomatike. "Rezultatet e zgjedhjeve, veçanërisht fitorja e demokratëve në Dhomën e Përfaqësuesve dhe në Senat, do ta shtyjnë patjetër administratën Trump të kërkojë një strategji për t'i dhënë fund luftës, veçanërisht përmes mjeteve diplomatike dhe negociatave", tha ajo.

Arayssi tha se demokratët mund t'i bllokojnë fonde shtesë për konfliktin dhe të nisin hetime për vendimet e administratës, pasi Kongresi i ri ta nisë punën në janar.

Ajo argumentoi se edhe Teherani mund të kërkojë kushte më të leverdishme në bisedime, duke llogaritur se mundësia politike e Trumpit për ta vazhduar fushatën ushtarake është dobësuar. "Kjo do të thotë gjithashtu se iranianët nuk do të jenë nën trysni për të ofruar kompromise të tjera", tha ajo.

Megjithatë, shumë analistë paralajmërojnë se, pavarësisht fitores së thellë të demokratëve, ndikimi i saj nuk është aspak i paracaktuar.

Trump mbetet komandant i përgjithshëm i forcave të armatosura dhe vazhdon të ketë kompetenca të mëdha mbi operacionet ushtarake dhe diplomacinë. Shumica e republikanëve e kanë mbrojtur fushatën kundër Iranit si të domosdoshme për t'iu kundërvënë kërcënimeve bërthamore dhe rajonale të Iranit, dhe pritet t'u rezistojnë përpjekjeve të demokratëve për ta kufizuar financimin e saj.

Megjithatë, pasojat ekonomike të konfliktit janë shndërruar në



barrë politike për administratën. Rritja e çmimeve të benzinës dhe naftës, pjesërisht e lidhur me ndërprerjet e qarkullimit në zonën përreth Ngushticës së Hormuzit, i ndihmoi demokratët që përballue-shmërinë e kostos së jetesës ta vendosnin në qendër të fushatës së tyre.

Kongresi i ri mund ta shtojë gjithashtu mbikëqyrjen ndaj Pentagonit dhe sekretarit të Mbrojtjes, Pete Hegseth, ndërsa negociatat për financimin mund të sjellin përplasje të tjera me Shtëpinë e Bardhë.

Ndërkohë, për Kievin, i cili prej më shumë se katër vjetësh është mbështetur në ndihmën amerikane për t'i zmbrapsur forcat pushtuese ruse, rezultatet sjellin pasiguri dhe shpresë njëkohësisht.

Disa nga mbështetësit më të njohur të Ukrainës në Kongres po largohen nga detyra. Në mesin e tyre është edhe kongresisti republikan Don Bacon, një kritik i zëshëm i Rusisë, i cili shpesh ka dalë kundër qëndrimeve të partisë së tij dhe të Shtëpisë së Bardhë lidhur me mbështetjen për Kievin. "Jam republikan i shkollës së vjetër të Ronald Reaganit dhe e shoh pushtimin rus të Ukrainës si krizën më të rëndësishme me të cilën përballet bota e lirë", i tha Bacon Radios Evropa e Lirë më 3 nëntor.

"Shpresoj që në Kongresin e 120-të të zgjidhen më shumë përfaqësues që do ta mbështesin fuqishëm mikun dhe aleatin tonë", shtoi ai.

Megjithatë, në mesin e ligjvënësve republikanë që po largohen janë edhe ish-lideri i shumicës në Senat, Mitch McConnell, senatorët Thom Tillis, Bill Cassidy dhe John Cornyn, si dhe kongresisti Michael McCaul. Largimi i tyre nënkupton humbjen e disa zërave me ndikim që kanë mbështetur një qasje më të ashpër ndaj Moskës.

Pavarësisht kësaj, organizatat ukrainaso-amerikane thonë se besojnë që mbështetja për Kievin do të vazhdojë të jetë dypartiake. "Edhe pse në këtë cikël zgjedhor po humbim disa mbështetës të jashtëzakonshëm të Ukrainës, jemi të vetëdijshëm për ata që do të mbeten dhe kemi arsye të besojmë se Ukraina do të vazhdojë të ketë mbështetje të konsiderueshme nga të dyja partitë", i tha Radios Evropa e Lirë Michael Sawkiw, president i Komitetit të Kongresit Ukrainas të Amerikës.

Sawkiw përmendi si prioritete mbikëqyrjen nga Kongresi të vendimit të fundit të administratës për të pezulluar përkohësisht disa sanksione ndaj Rusisë dhe marrëveshjen e saj për naftë dizel, rritjen e ndihmës për sigurinë e Ukrainës, si dhe zgjatjen e statusit të mbrojtjes së përkohshme për refugjatët ukrainas. "Shtetet e Bashkuara duhet të vazhdojnë të jenë lider botëror për ata që shtypen ose përballen me agresion të huaj. Ne jemi të përkushtuar të punojmë me zyrtarët e rizgjedhur, si dhe me ata që sapo janë zgjedhur, për t'i çuar përpara çështjet që kanë rëndësi për ne", tha ai.

Dy këshilltarë të lartë republikanë për politikën e jashtme në Senat i thanë gjithashtu Radios Evropa e Lirë se zgjedhjet mund ta shtojnë trysninë ndaj Kongresit për vendosjen e sanksioneve ndaj Rusisë. Ata iu referuan projektligjit për sanksione, të cilit së fundmi i është dhënë shtysë dhe që lidhet me senatorin Lindsey Graham. Motra e tij humbi në zgjedhje, pasi ishte emëruar në këtë post në korrik, pas vdekjes së papritur të vëllait të saj.

Prandaj, kontrolli i Kongresit nga demokratët mund t'i vështirësojë përpjekjet e Trumpit për të krijuar marrëdhënie më të mira me Moskën, veçanërisht nëse administrata e tij kërkon lehtësimin e më shumë sanksioneve.

Megjithatë, ligjvënësit përballen me kufizime. E drejta e Trumpit për veto dhe kundërshtimi i republikanëve mund t'i pengojnë përpjekjet për vendosjen e kufizimeve të reja ose për ta detyruar administratën ta rrisë ndihmën ushtarake për Ukrainën.

Kontrolli i Senatit nga demokratët do t'i japë kësaj partie gjithashtu më shumë ndikim mbi kalendarin legjislativ, hetimet e komiteteve dhe konfirmimin e emërimeve në administratë dhe në sistemin gjyqësor.

Senatori demokrat, Chuck Schumer, pritet të rikthehet në vitin 2027 në postin e liderit të shumicës në Senat.

Demokratët pritet të fitojnë 258 vende në Dhomën e Përfaqësuesve, rezultati më i mirë në mbi tri dekada

Sipas projeksioneve të "NBC News", demokratët pritet të fitojnë 258 vende në Dhomën e Përfaqësuesve të Kongresit amerikan. Nëse ky parashikim konfirmohet, republikanët do të humbasin 43 vende dhe do të mbeten me 177 përfaqësues. Në zgjedhjet afatmesme të vitit 2018, gjatë mandatit të parë të Trumpit, republikanët humbën 42 vende në këtë dhomë.

Demokratët nuk kanë arritur një numër kaq të madh vendesh që nga viti 1993, kur Bill Clinton mori detyrën e presidentit të ShBA-së.

Për ta siguruar kontrollin e Dhomës së Përfaqësuesve, demokratëve u nevojiteshin vetëm 218 vende. Fitorja e tyre pritej, por jo me një diferencë kaq të madhe.

Përmasat e humbjes republikane pritet të ndikojnë ndjeshëm në planet politike të Trumpit për dy vitet e fundit të mandatit të tij, duke ia vështirësuar miratimin nismave legjislative në Kongres.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Hoxhaj në Konferencën e Sigurisë në Berlin, kërkon anëtarësim të Kosovës në NATO

PRISHTINË, 4 NËNTOR - Deputeti dhe ish-ministri i Punëve të Jashtme, Enver Hoxhaj, ka marrë pjesë në një debat të nivelit të lartë në kuadër të Konferencës së Sigurisë në Berlin, me temën "Angazhimi i besueshëm në Jug". Në këtë panel, Hoxhaj ishte së bashku me gjenerallejtënant Iulian Berdila, zëvendësshef i Mbrojtjes për Operacione dhe Trajnim në Rumani, dhe gjenerallejtënant Nuno Lemos Pires, drejtor i Politikës Kombëtare të Mbrojtjes në Ministrinë e Mbrojtjes të Portugalisë.
Debati u moderua nga Javier Colomina, përfaqësues i posaçëm i NATO-s për Fqinjësinë Jugore.
Përmes një postimi Hoxhaj ka theksuar se bota po kalon një periudhë tranzicioni, ndërmjet një rendi botëror që po shpërbëhet dhe një rendi të ri që ende nuk ka marrë formë. Ai ka vlerësuar se dobësimi i institucioneve ndërkombëtare dhe ambiciet perandorake të Rusisë e bëjnë të domosdoshëm një rol më të fuqishëm të Bashkimit Evropian në Ballkan, përfshirë edhe në fushën e sigurisë.
Hoxhaj ka theksuar se për Kosovën dhe rajonin angazhimi i qëndrueshëm i Bashkimit Evropian dhe NATO-s mbetet jetik për ruajtjen e paqes dhe të ardhmen euroatlantike.



PROKURORIA SPECIALE JEP HOLLËSI PËR SEKUESTRIMIN E MBI 37 KILOGRAMËVE HEROINË



PRISHTINË, 4 NËNTOR - Një operacion i përbashkët i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës dhe Policisë së Kosovës, në bashkëpunim me Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë (AKI), ka rezultuar me arrestimin e pesë personave dhe sekuestrimin e mbi 37 kilogramëve substancë të dyshuar narkotike të llojit heroinë.
Hollësitë e këtij operacioni janë bërë me dije në një konferencë për medie nga ushtruesi i detyrës së kryeprokurorit të Prokurorisë Speciale, Dren Paca. Ai ka njoftuar se në mesin e pesë të arrestuarve janë edhe dy shtetas të huaj. "Mbrëmë Prokuroria Speciale, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, ka realizuar me sukses një aksion gjatë të cilit janë arrestuar pesë persona, dy prej të cilëve janë të huaj", tha Paca, duke shtuar se janë sekuestruar mbi 37 kilogramë substancë e dyshuar narkotike e llojit heroinë.
Sipas Pacës, operacioni është rezultat i një hetimi të zhvilluar së fundmi, i cili është bazuar në informacione të siguruara nga Agjencia e Kosovës për Inteligjencë. "Ky aksion është rezultat i një hetimi të zhvilluar së fundmi mbi bazën e informacioneve të siguruara nga Agjencia Kosovare për Inteligjencë, falë bashkëpunimit të ndërsjellë, me çka është realizuar në afat rekord", deklaroi ai.
Ndërkaq prokurori i rastit, Atdhe Dema, ka bërë me dije se vlera e substancës së sekuestruar vlerësohet të jetë rreth 550 mijë euro. "Mbrëmë është zhvilluar një aksion me sukses në një afat rekord të hetimeve në bashkëpunim me policinë dhe AKI-në. Si rezultat i veprimeve të ndërmarra janë arrestuar pesë persona. Janë sekuestruar sasi prej 37 kg heroinë në vlerë prej 550 mijë eurosh", tha Dema.

OVLUÇK-JA ORGANIZON AKTIVITET PARA ZYRËS SË BE-SË NË GJASHTËVJETORIN E ARRESTIMIT TË ISH-KRERËVE TË UÇK-SË

PRISHTINË, 4 NËNTOR - Organizata e Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVL-UÇK) do të organizojë të enjten një aktivitet simbolik para zyrës së Bashkimit Evropian në Prishtinë, në shënim të gjashtëvjetorit të arrestimit të ish-krerëve të UÇK-së, ka bërë me dije nënkryetari i OVLUÇK-së, Gazmend Syla, në një konference për medie.
Syla tha se përmes këtij aktiviteti synojnë ta shprehin solidaritetin me ish-krerët e UÇK-së dhe të kundërshtojnë atë që e cilësojnë si padrejtësi ndaj tyre. "Nesër bëhen gjashtë vjet nga arrestimi i ish-krerëve të UÇK-së. Me këtë rast do të organizojmë një aktivitet simbolik për ta shprehur solidaritetin tonë me ish-krerët e UÇK-së. Aktiviteti do të mbahet nesër, në orën 12:00, para zyrës së Bashkimit Evropian në Prishtinë", deklaroi Syla.



Ai bëri me dije se kanë kërkuar edhe nga Asociacioni i Komunave të Kosovës që kryetarët e komunave t'i bashkohen këtij aktiviteti, duke dalë para objekteve komunale në shenjë solidarizimi. Sipas tij, aktiviteti do të jetë paqësor dhe institucional.
Ndërsa duke folur për kthimin e Ligjit për Dhomat e Specializuara, Syla shprehu zhgënjimin e OVLUÇK-së, duke kërkuar reflektim nga deputetët e Kuvendit të Kosovës. Ai vlerësoi se kthimi i ligjit ishte i papranueshëm dhe se çdo ligj tjetër që mund të vijë më pas do të jetë më i dobët se versioni paraprak. "Jemi shumë të zhgënjyer dhe po presim reflektimin edhe një herë të deputetëve. Jemi të bindur se çfarëdo ligji që vjen pas tij do të jetë më i dobët se ky që ka qenë, prandaj kjo çështje mbetet në përgjegjësinë e Kuvendit të Kosovës", theksoi Syla.

Macroni uron presidenten Shiroka-Pula, shpreh mbështetjen e Francës për dialogun Kosovë - Serbi

PRISHTINË, 4 NËNTOR - Presidentja e Republikës së Kosovës, Justina Shiroka-Pula, ka marrë letër urimi nga presidenti i Republikës së Francës, Emmanuel Macron, me rastin e marrjes së detyrës.
Në letrën e tij, presidenti Macron i përcolli presidentes Shiroka-Pula urimet më të përzemërta dhe shfaqi shpresën se zgjedhja e saj do të mundësojë rifillimin e përparimit në fushat që kontribuojnë në perspektivën evropiane të Kosovës.
Presidenti Macron ka rikujtuar takimin me kryeministrin Albin Kurti në Paris, në mars të këtij viti, si dhe partneritetin historik ndërmjet Francës dhe Kosovës. Ai shprehu kënaqësinë që vizita e ministrit të deleguar për Evropën në Kosovë, gjatë muajit korrik, mundësoi nënshkrimin e marrëveshjeve të reja ndërmjet dy vendeve.
Në letër ai nënvizoi rëndësinë e normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, duke riafirmuar mbështetjen e Francës për dialogun e lehtësuar nga Bashkimi Evropian.





RAPORTI I BE-së: KOSOVA KA NGECUR NË REFORMAT KYÇE PËR INTEGRIM

- Asnjë përparim në gjyqësor, më pak dënime për korrupsion të nivelit të lartë dhe reforma të ngecura

PRISHTINË, 4 NËNTOR - Kosova vazhdon të ngecë në disa nga reformat kryesore që duhet ta afrojnë me Bashkimin Evropian.
Gjyqësori nuk ka shënuar asnjë përparim, lufta kundër korrupsionit ka dhënë rezultate të kufizuara, ndërsa krizat politike kanë dobësuar funksionimin e institucioneve.
Kjo është tabloja që paraqet Komisioni Evropian në raportin e tij për Kosovën për vitin 2026, ku paralajmëron se ndikimet politike dhe ekonomike në sistemin e drejtësisë mbeten pengesë serioze për pavarësinë e tij dhe, në disa aspekte, madje janë rritur.
Raporti evidenton rënie të numrit të vendimeve përfundimtare dhe dënimeve për korrupsion të nivelit të lartë, si dhe mangësi në mbikëqyrjen parlamentare të qeverisë.
Megjithatë, jo të gjitha vlerësimet janë negative.
Komisioni vëren përparim në administratën publike, zgjerimin e shërbimeve digjitale dhe shtensionimin e situatës në veri të Kosovës, që mundësoi heqjen e masave ndëshkuese të BE-së.
Dokumenti, i titulluar "Raporti për Kosovën 2026", është pjesë e Paketës së Zgjerimit të Bashkimit Evropian. Ai mbulon periudhën nga 1 shtatori 2025 deri më 1 shtator 2026, por përfshin edhe disa zhvillime të mëvonshme.
Vlerësimi vjen dhjetë vjet pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe gati katër vjet pasi Kosova aplikoi për anëtarësim në BE.

Politika pengoi reformat

Dy palë zgjedhje të parakohshme parlamentare, periudha të gjata bllokadash dhe një qeveri me kompetenca të kufizuara për pjesën më të madhe të periudhës së raportimit, kanë lënë gjurmë në funksionimin e institucioneve.
Sipas Komisionit, Kuvendi ka ushtruar kompetencat e tij me mangësi të konsiderueshme, ndërsa mbikëqyrja e ekzekutivit ka qenë shumë e kufizuar.
Zgjedhjet u vlerësuan përgjithësisht paqësore dhe konkurruese, por raporti identifikon përpjekje për politizimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, mangësi në rregullimin e fushatave dhe trajtim të pamjaftueshëm të dezinformimit.
Një tregues tjetër i ndikimit të krizave politike ishte rënia e pjesëmarrjes në zgjedhje, nga 45 për qind në dhjetor të vitit 2025, në 37 për qind në qershor të vitit 2026.
Komisioni vlerëson se kjo sugjeron lodhje në rritje të votuesve dhe pakënaqësi me shpeshtësinë e zgjedhjeve.

Drejtësia, një nga pikat më të dobëta

Për funksionimin e gjyqësorit, vlerësimi i Komisionit është i qartë: në përgjithësi, nuk është shënuar përparim.
Ndikimet e papërshtatshme nga interesa politike, ekonomike dhe faktorë të tjerë vazhdojnë ta pengojnë pavarësinë dhe paanshmërinë e sistemit, ndërsa paketa e ligjeve për reformimin e drejtësisë mbetet e pamiratuar.
Komisioni ngre shqetësime edhe për zbatimin e ndryshimeve në Ligjin për Këshillin Prokurorial dhe kërkon respektimin e rekomandimeve të Komisionit të Venecias.
Megjithatë, evidenton zhvillime pozitive në procesin e përzgjedhjes së kryeprokurorit të Shtetit dhe ndryshimet në përbërjen e Këshillit Prokurorial.
Një shqetësim tjetër është përfaqësimi i pamjaftueshëm i serbëve të Kosovës në gjyqësor që, sipas raportit, cenon karakterin shumetnik të sistemit të drejtësisë.
Vëmendje të veçantë marrin edhe ndryshimet në Ligjin për Dhomat e Specializuara, të miratuara nga Kuvendi më 6 tetor.
Komisioni paralajmëron se ato ngrenë shqetësime serioze për përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare të Kosovës, pavarësinë e gjyqësorit, mbrojtjen e viktimave dhe dëshmitarëve, si dhe sigurimin e përgjegjësisë për krimet e luftës.
Ai ngre, gjithashtu, shqetësime për kushtetutshmërinë e ndryshimeve, të cilat presidentja i ktheu në Kuvend për rishqyrtim më 22 tetor.

Më shumë raportime për korrupsion, më pak dënime të nivelit të lartë

Në luftën kundër korrupsionit, Komisioni Evropian vlerëson se Kosova ka shënuar përparim të kufizuar.
Ndërsa numri i vendimeve gjyqësore përfundimtare dhe dënimeve në rastet e korrupsionit që nuk i përkasin nivelit të lartë është rritur ndjeshëm, në rastet e nivelit të lartë ka shënuar rënie.
Raporti thekson se Kosova vazhdon të mos ketë një strategji gjithëpërfshirëse kundër korrupsionit dhe një qasje të koordinuar për luftimin e tij.
Ndërkohë, numri i raportimeve të sinjalizuesve të pranuara nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit pothuajse është dyfishuar krahasuar me vitin paraprak.
Komisioni kërkon gjithashtu përmirësimin e verifikimit të deklarimeve të pasurisë dhe forcimin e hetimeve në rastet e korrupsionit të nivelit të lartë.

Medie të lira, por me sfida

Përparim i kufizuar është shënuar edhe në lirinë e shprehjes dhe të medieve.
Komisioni vlerëson se Kosova vazhdon të ketë një mjedis mediatik pluralist, por evidenton probleme me transparencën e pronësisë dhe qëndrueshmërinë financiare të mediave.

Situata paraqitet veçanërisht shqetësuese në zonat me shumicë serbe, sidomos në veri, ku mjedisi kufizues nxit autocensurën.
Raporti kërkon miratimin e një ligji të ri për Komisionin e Pavarur të Medieve dhe rishikimin e ligjit për Radiotelevizionin e Kosovës, për të siguruar financim të qëndrueshëm dhe pavarësi institucionale.
Shqetësime ngrihen edhe për mbrojtjen e të drejtave themelore, përfshirë rrënimin e pronave private në veri pa respektimin e duhur të procedurave ligjore, ndërkohë që kundërshtimet gjyqësore ishin ende në shqyrtim.

Dialogu me Serbinë: Pak përparim, shumë detyrime të pazbatuara

Kosova dhe Serbia nuk kanë bërë përparim të mjaftueshëm në zbatimin e Marrëveshjes së Ohrit të vitit 2023, ndërsa veprimet e njëanshme dhe retorika e të dyja palëve vazhdojnë ta pengojnë normalizimin e marrëdhënieve, vlerëson Komisioni Evropian. Sipas raportit, dialogu ka vazhduar me takime të rregullta në nivel kryenegociatorësh dhe ekipesh teknike, por zbatimi i detyrimeve të mbetura nga marrëveshjet e dialogut mbetet i kufizuar.
Komisioni kërkon që Kosova ta nisë procesin për vendosjen e aranzhimeve të vetëmenaxhimit për komunitetin serb, ndërsa Serbia, paralelisht, ta fillojë njohjen e dokumenteve, simboleve dhe institucioneve të Kosovës.
Raporti thekson se Marrëveshja e Ohrit është ligjërisht e detyrueshme për të dyja palët dhe duhet të zbatohet pa vonesa apo parakushte.
Situata në veri të Kosovës vlerësohet e qetë, por e brishtë.
Komisioni kritikon veprimet e përsëritura të autoriteteve të Kosovës ndaj strukturave dhe shërbimeve të mbështetura nga Serbia, arrestimet e serbëve të Kosovës dhe mospranimin e tërheqjes së dorëheqjeve të gjyqtarëve dhe prokurorëve serbë, që ka penguar riintegrimin e tyre në sistemin e drejtësisë.
Në anën tjetër, komisioni kritikon Serbinë për lobimin kundër anëtarësimit të Kosovës në organizata ndërkombëtare, përfshirë Këshillin e Evropës dhe Interpolin, si dhe për retorikën nxitëse të zyrtarëve të saj.
Raporti thekson, gjithashtu, se Serbia nuk ka ndërmarrë hapa domethënës për të siguruar përgjegjësi për sulmin e armatosur ndaj Policisë së Kosovës në Banjskë në shtator të vitit 2023.
Komisioni paralajmëron se normalizimi i marrëdhënieve dhe zbatimi i marrëveshjeve të dialogut mbeten kushte thelbësore për rrugën evropiane të të dyja vendeve, të cilat rrezikojnë të humbasin mundësi të rëndësishme, në mungesë të përparimit.

Ku ka bërë Kosova përparim?

Përkundër ngecjeve në drejtësi dhe luftën kundër korrupsionit, Komisioni Evropian evidenton njëfarë përparimi në reformën e administratës publike, veçanërisht në rekrutimet e centralizuara dhe zgjerimin e shërbimeve digjitale. Megjithatë, vazhdojnë vonesat në riorganizimin e institucioneve dhe klasifikimin e vendeve të punës.
Zhvillim pozitiv vlerësohet edhe kalimi i qetë i pushtetit lokal në veri, pas zgjedhjeve të vitit 2025, që mundësoi heqjen e masave të BE-së ndaj Kosovës dhe rifillimin e ndihmës financiare.
Në dialogun me Serbinë, raporti veçon marrëveshjen e marsit 2026 për zbatimin e Ligjit për të Huajt, që lidhet me rregullimin e statusit të punonjësve dhe studentëve në institucionet e mbështetura nga Serbia.
Por, Komisioni thekson se zhvillimet e brendshme politike kanë penguar përparimin në zbatimin e Marrëveshjes së Ohrit.
Raporti konstaton se integrimi evropian vazhdon të gëzojë mbështetje të gjerë në Kosovë, porse përparimi i pabarabartë në reforma dhe dobësitë në sundimin e ligjit mbeten pengesa në rrugën drejt BE-së.



Kos: Bllokada institucionale ka ndikuar në zbatimin e reformave evropiane në Kosovë



Komisionerja e Bashkimit Evropian për Zgjerim, Marta Kos, ka deklaruar se bllokadat institucionale kanë ndikuar në zbatimin e reformave evropiane nga Kosova. “Bllokada institucionale ka ndikuar në zbatimin e reformave që lidhen me Bashkimin Evropian gjatë periudhës raportuese. Megjithatë, së fundmi Kosova ka intensifikuar zbatimin e agjendës së reformave. BE-ja e ka mirëpritur zgjedhjen e presidentes së re dhe shpresojmë që stabiliteti i ripërtërirë institucional do t’i mundësojë Kosovës të përparojë”, ka deklaruar Kos.
Ndërkaq sa i përket Serbisë, Kos ka deklaruar se ka shënuar hapa prapa në fushat themelore, veçanërisht në të drejtat themelore, lirinë e shprehjes, lirinë akademike dhe administratën publike. Ajo ka thënë se qeveria e re serbe do ta ketë mundësinë ta ndryshojë këtë kurs dhe ta shfrytëzojë mundësinë për një fillim të ri. Kos ka vlerësuar se Serbia është ndër vendet kandidate me nivelin më të lartë të përafrimit me legjislacionin e Bashkimit Evropian dhe është e përgatitur mirë për tregun e vetëm dhe konkurrueshmërinë. “Në Serbi kemi vërejtur hapa prapa në të gjitha fushat themelore. Qeveria e re do të ketë mundësinë ta ndryshojë këtë kurs. Serbia ka bërë hapa të mëtejshëm prapa në fushën e të drejtave themelore, veçanërisht sa i përket lirisë së shprehjes dhe lirisë akademike, si dhe në administratën publike. Serbia është ndër vendet kandidate me nivelin më të lartë të përafrimit me legjislacionin e BE-së dhe është e përgatitur mirë për tregun e vetëm dhe konkurrue-shmërinë. Tani Serbia ka mundësinë për një fillim të ri. Qeveria e re serbe ka mundësinë ta kthejë një faqe të re, të forcojë institucionet demokratike dhe të drejtat themelore, si dhe të ndërmarrë hapat e nevojshëm për të avancuar në rrugën e anëtarësimit të Serbisë në Bashkimin Evropian”, ka theksuar Kos.

Shqipëria ka shënuar përparim në zbatimin e reformave kyçe

Komisionerja për Zgjerim, Marta Kos, u shpreh në Parlamentin Evropian se Shqipëria ka bërë një rrugë të mirë drejt integrimit në BE, duke mbyllur 4 kapituj deri tani, ndërsa tha se duhet ta vijojë punën për arritjen e synimit për t’u bërë pjesë e BE-së dhe për mbylljen e negociatave deri në fund të vitit 2027. Ajo u shpreh se vendi ynë duhet të punojë më shumë në çështjet që lidhen me drejtësinë dhe mjedisin, të cilat, sipas saj, shërbejnë edhe për vetë popullin dhe jo vetëm për rrugën drejt BE-së. “Ritmi me të cilin Shqipëria po zbaton reformat e BE-së është një tregues i angazhimit të saj për anëtarësimin në Bashkimin Evropian. Është shënuar përparim në zbatimin e reformave kyçe. Këtë vit u arrit një etapë e rëndësishme me përmbushjen e kritereve të ndërmjetme për grupkapitullin e parë, atë të Themeloreve. Që prej asaj kohe, Shqipëria ka mbyllur përkohësisht katër kapituj dhe po punon për përmbushjen e kritereve përmbyllëse për kapituj të tjerë. Në të njëjtën kohë, do të na duhet të shohim një vijimësi të përqendrimit te përparimi në fushat kyçe. Kjo është e rëndësishme që Shqipëria të përmbushë objektivin e saj ambicioz, por të arritshëm, për mbylljen e negociatave deri në fund të vitit 2027. Në qendër të çdo përpjekjeje për reforma duhet të jenë sundimi i ligjit, një gjyqësor i pavarur, liria e medias dhe mbrojtja e të drejtave themelore. Përparimi në çështjet mjedisore duhet të jetë gjithashtu një përparësi. Këto çështje kanë rëndësi jo vetëm për anëtarësimin në BE, por edhe për shoqërinë shqiptare dhe jetën e përditshme të qytetarëve”, tha ajo.



MPB dhe Policia e Kosovës paraqitën në Sarajevë arritjet dhe prioritetet në luftimin e terrorizmit dhe parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm



Prishtinë, 4 nëntor - Përfaqësues të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Policisë së Kosovës morën pjesë në takimin dyditor të Rrjetit Rajonal të Koordinatorëve Kombëtarë për Luftimin e Terrorizmit dhe Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm (RNNC), të mbajtur më 28-29 tetor 2026 në Sarajevë.

Gjatë takimit u paraqitën të arriturat e Kosovës në zbatimin e Planit të Përbashkët të Veprimit kundër Terrorizmit me Komisionin Evropian, avancimi i kornizës ligjore për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, si dhe kontributi në raportin rajonal për trendët dhe situatën e terrorizmit në Ballkanin Perëndimor.

Një ndër prioritetet e paraqitura ishte edhe rishikimi i Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare kundër Terrorizmit për periudhën 2026-2028, në të cilin do të integrohen edhe masat dhe objektivat e përcaktuara në Udhërrëfyesin e ri.

Kosova riafirmoi përkushtimin për thellimin e bashkëpunimit me partnerët rajonalë dhe Bashkimin Evropian, me synim forcimin e sigurisë së përbashkët dhe adresimin efektiv të kërcënimeve të përbashkëta.

KURTI: SHËNDETI MENDOR I FËMIJËVE DHE ADOLESHENTËVE DUHET TË JETË PRIORITET INSTITUCIONAL



Prishtinë, 4 nëntor - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se shëndeti mendor i fëmijëve dhe adoleshentëve duhet të jetë pjesë e pandashme e politikave shtetërore, duke theksuar nevojën për investime në parandalim, identifikim dhe mbështetje të hershme. Këto deklarata Kurti i bëri në tryezën "Dialogu strategjik për shëndetin mendor dhe mbështetjen psikosociale për fëmijët dhe adoleshentët", ku u diskutuan sfidat dhe masat që duhet të ndërmerren për avancimin e shërbimeve të shëndetit mendor në Kosovë.

Ai tha se raporti i hartuar nga UNICEF-i, në bashkëpunim me Institutin e Psikologjisë të Universitetit të Prishtinës, ofron një pasqyrë të rëndësishme të gjendjes dhe rekomandime konkrete për përmirësimin e shërbimeve. "Takimi i sotëm duhet të na çojë nga evidenca te veprimi. Tashmë kemi një dokument më së qartë që t'i kuptojmë sfidat dhe nevojat. Përgjegjësia jonë tani është të përcaktojmë se ku duhet t'i përqendrojmë përpjekjet tona", deklaroi Kurti.

Kreu i qeverisë theksoi se shëndeti mendor nuk është përgjegjësi vetëm e një sektori apo institucioni, por kërkon bashkëpunim ndërmjet shëndetësisë, arsimit, shërbimeve sociale, drejtësisë dhe sektorëve të tjerë.

Kurti përmendi edhe disa nga masat e ndërmarra nga qeveria gjatë mandatit të saj, përfshirë shtesat për fëmijët, mbështetjen për nënat lehona, programin e intervenimit të hershëm për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe mundësitë për fuqizimin e punësimin e të rinjve.

Ai bëri thirrje që institucionet të mos përqendrohen vetëm në zgjidhje afatshkurtra, por të ndërtojnë politika që japin rezultate në periudhën afatmesme dhe afatgjatë.

"Kur vjen puna te shëndeti mendor, te shëndeti publik, për fëmijët, adoleshentët dhe jo vetëm, nuk ka zgjidhje të njëhershme dhe të menjëhershme. Pra, duhet të përgatitemi e të punojmë për rezultate të cilat nuk do t'i kemi në vitin 2026, nuk do t'i kemi as në vitin 2027, por në vitet në vijim", u shpreh Kurti.

Në fund ai falënderoi UNICEF-in, Universitetin e Prishtinës, ministritë, institucionet, profesionistët e shëndetit mendor, organizatat joqeveritare dhe partnerët e tjerë, për kontributin në këtë proces.

KATËR ORGANIZATA U BËJNË THIRRJE PRINDËRVE T'I VAKSINOJNË FËMIJËT

Prishtinë, 4 nëntor - Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve (KOMF), Aksioni për Nëna dhe Fëmijë (AMC), Shoqata për të Drejtat e Pacientëve (PRAK) dhe Instituti i Evropës Juglindore për Politika Shëndetësore dhe Sociale (IEJL-PShS), kanë shprehur shqetësimin për përhapjen e fruthit dhe u kanë bërë thirrje prindërve të bëjnë vaksinimin e rregullt të fëmijëve.

Sipas të dhënave të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK), nga 16 prilli deri më 1 nëntor 2026 janë konfirmuar gjithsej 269 raste me fruth, prej të cilave 27 vetëm gjatë javës së fundit.



Organizatat kanë rikujtuar se fruthi është sëmundje shumë ngjitëse, e cila mund të shkaktojë ndërlikime serioze shëndetësore, veçanërisht te fëmijët e vegjël. Ato u kanë bërë thirrje prindërve dhe kujdestarëve të kontrollojnë statusin e vaksinimit të fëmijëve dhe të sigurohen se kanë marrë të gjitha dozat e rekomanduara sipas kalendarit të rregullt të vaksinimit.

Prindërit, fëmijët e të cilëve nuk i kanë marrë të gjitha dozat, janë inkurajuar të drejtohen në qendrat e mjekësisë familjare për këshillim dhe vaksinim plotësues.

Në komunikatën e përbashkët theksohet gjithashtu rëndësia e informimit të drejtë të prindërve nga profesionistët shëndetësorë, duke u bazuar në dëshmi shkencore.

Organizatat kanë përmendur edhe vlerësimin më të fundit të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSh), të publikuar në shtator 2026, sipas të cilit, dëshmitë shkencore nuk mbështesin ekzistencën e një lidhjeje shkakësore ndërmjet vaksinave, përfshirë vaksinën MMR, dhe çrregullimeve të spektrit të autizmit.

Në fund, KOMF, AMC, PRAK dhe IEJL-PShS kanë vlerësuar përpjekjet e Ministrisë së Shëndetësisë, IKShPK-së, komunave dhe profesionistëve shëndetësorë për vaksinimin dhe mbrojtjen e shëndetit të fëmijëve, duke shprehur gatishmërinë për ta vazhduar bashkëpunimin me institucionet dhe familjet për rritjen e mbulueshmërisë me vaksinim.

Maqedonci takon ministrin gjerman Florian Hahn, diskutojnë për mbrojtjen

Prishtinë, 4 nëntor - Ministri i Mbrojtjes i Kosovës, Ejup Maqedonci, është takuar me ministrin e Shtetit në Ministrinë Federale të Punëve të Jashtme të Gjermanisë, Florian Hahn, në kuadër të Konferencës së Sigurisë në Berlin.

Sipas njoftimit të Maqedoncit, në takim është diskutuar për zhvillimet e fundit në rajon, thellimin e bashkëpunimit bilateral ndërmjet Kosovës dhe Gjermanisë, forcimin e partneritetit në fushën e mbrojtjes dhe industrisë ushtarake, si dhe avancimin e subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës.

Më tej, Maqedonci bëri me dije se gjatë takimit ministri gjerman Hahn shprehu mbështetjen për proceset integruese të Kosovës dhe perspektivën e saj euroatlantike.



MBI 4 MILIARDË EURO NË PROJEKTBUXHET: KUSH MERR SA?



Mbi 1.4 miliard euro për subvencione dhe transfere, më shumë se një miliard për paga dhe po aq për investime kapitale. Këto janë ndarjet kryesore të projektbuxhetit të Kosovës për vitin 2027, i cili parashihet të arrijë në 4.27 miliardë euro.

Projektbuxheti, i miratuar nga Qeveria e Kosovës më 2 nëntor dhe i siguruar nga Radio Evropa e Lirë, është rreth 300 milionë euro më i lartë se buxheti fillestar i vitit 2026, apo 200 milionë euro më i lartë se buxheti i rishikuar. Ai tashmë i është dërguar Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Ku do të shkojë pjesa më e madhe e parave?

Pjesa më e madhe e buxhetit, rreth 1.45 miliard euro, është planifikuar për subvencione dhe transfere - kategori që përfshin pensionet, shtesat për fëmijë, ndihmat sociale dhe forma të tjera të mbështetjes financiare. Sipas ministrit të Financave, Hekuran Murati, kjo kategori është rritur për 6.5 për qind krahasuar me vitin 2026, kryesisht për shkak të rritjes së planifikuar të shtesave për fëmijë dhe pensioneve. Pas saj renditen shpenzimet për paga, me 1.085 miliard euro, apo rreth një të katërtën e buxhetit të përgjithshëm.

Për krahasim, në buxhetin fillestar të vitit 2026 për paga dhe shtesa ishin planifikuar mbi 980 milionë euro.

Për investime kapitale janë paraparë rreth 1.07 miliard euro, krahasuar me 998 milionë euro në buxhetin fillestar të vitit 2026.

Për mallra dhe shërbime janë planifikuar rreth 547 milionë euro, më shumë se një vit më parë.

Rritje e mjeteve parashihet edhe për barna esenciale.

Sipas kryeministrit Albin Kurti, një pjesë e tyre është siguruar përmes përgjysmimit të buxhetit për udhëtime jashtë vendit.

Rritje është paraparë edhe në financimin e komunave, për të cilat janë ndarë 908 milionë euro, krahasuar me 867 milionë euro në buxhetin fillestar të vitit 2026.

Cilat ministri marrin më shumë dhe cilat më pak?

Projektbuxheti i vitit 2027 parasheh rritje të mjeteve për disa ministri, por edhe shkurtime për të tjera.

Nga të gjitha ministritë, Ministria për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare ka buxhetin më të lartë për vitin 2027, me mbi 1.1 miliard euro, ndërsa buxhetin më të vogël e ka Ministria e Zhvillimit Rural.

Ministria e Mbrojtjes pritet të ketë tetë milionë euro më shumë se në vitin 2026, ndërsa Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës pesë milionë euro më shumë.

Rritje janë planifikuar edhe për Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, me 7.7 milionë euro, dhe Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, me rreth 1.9 milion euro.

Në anën tjetër, ulja më e madhe, sipas këtyre krahasimeve, është paraparë për Ministrinë e Ekonomisë. Buxheti i saj pritet të bjerë nga rreth 79 milionë euro në vitin 2026, në 23.4 milionë euro në vitin 2027 - një zvogëlim prej rreth 55.6 milionë eurosh. Radio Evropa e Lirë nuk ka arritur ta konfirmojë arsyen e kësaj uljeje, as nga dokumenti i projektbuxhetit dhe as nga Ministria e Ekonomisë dhe ajo e Financave.

Buxheti i Ministrisë së Shëndetësisë pritet të ulet, po ashtu, për mbi 1.3 milion euro, ndërsa ai i Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës të rritet nga 199, në mbi 217 milionë euro në vitin 2027.

Për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës janë planifikuar rreth dy milionë euro më pak se në vitin 2026, por krahasimi nuk është i drejtpërdrejtë, pasi teknologjia dhe inovacioni nuk janë më pjesë e fushëveprimit të saj.

Çfarë investimesh janë planifikuar?

Për herë të parë shpenzimet e planifikuara për investime kapitale kalojnë pragun prej një miliard eurosh, duke përbërë rreth një të katërtën e buxhetit. Sipas projektbuxhetit, investimet do të përqendrohen në përmirësimin e infrastrukturës së transportit dhe energjisë, si dhe të kushteve në arsim, shëndetësi dhe shërbime sociale.

Ndër projektet që qeveria ka veçuar janë: ndërtimi i Unazës së Jashtme të Prishtinës, segmenti rrugor Duhël-Banullë, që lidh dy autostradat kryesore të vendit, si dhe autoudha e Dukagjinit.

Janë paralajmëruar gjithashtu investime në ndërtimin e digave, infrastrukturën sportive për Lojërat Mesdhetare të vitit 2030 dhe zhvillimin e turizmit.

Megjithatë, ndarja e mjeteve në buxhet nuk garanton realizimin e projekteve.

Sipas ministrit Murati, gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2026 janë realizuar vetëm 37 për qind e investimeve të planifikuara kapitale. Ai ua atribuoi këtë nivel të realizimit, ndër të tjera, vonesave në procedurat e prokurimit publik dhe faktit që Kosova e nisi vitin pa buxhet të miratuar.

Buxheti i vitit 2026 u miratua vetëm më 20 shkurt, pas një periudhe krize politike dhe institucionale, gjatë së cilës institucionet funksionuan me financim të përkohshëm.

Çfarë ndryshon për pagat dhe shtesat?

Një pjesë e rritjes së buxhetit për paga lidhet me vendimin e qeverisë për ta ngritur vlerën e koeficientit të pagave në sektorin publik nga 110 në 120 euro, duke filluar nga 1 korriku 2027.

Punonjësit që paguhen nga buxheti i shtetit pritet të përfitojnë edhe pagën e 13-të gjatë pjesës së parë të vitit, siç ndodhi edhe në vitin 2026. Sipas kryeministrit Kurti, këto masa e çojnë buxhetin e pagave në 1.085 miliard euro.

Projektbuxheti parasheh gjithsej 91.631 pozita pune në sektorin publik, apo 470 më shumë se në buxhetin e vitit 2026. Kjo shifër tregon numrin e pozitave të planifikuara, jo domosdoshmërisht të punonjësve të angazhuar.

Rritje janë paraparë edhe për shtesat e fëmijëve. Nga 1 janari 2027 ato pritet të rriten për 25 për qind, ndërsa qeveria synon rritje të tjera vjetore deri në dyfishimin e tyre në vitin 2030. Sipas shembullit të dhënë nga Kurti, një familje me dy fëmijë, që aktualisht merr 60 euro në muaj, pritet të marrë 75 euro nga janari.

Çfarë tjetër parasheh projektbuxheti?

Përveç pagave, mbështetjes sociale dhe investimeve infrastrukturore, qeveria ka paralajmëruar financimin edhe të disa nismave të tjera. Një prej tyre është themelimi i kompanisë së parë ajrore të Kosovës.

Projektbuxheti parasheh gjithashtu rritjen e mbështetjes financiare për ekipet mbrojtëse të katër ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të dënuar në shkallë të parë për krime lufte nga Dhomat e Specializuara në Hagë, më 16 shtator.

Çfarë pritet nga ekonomia dhe çmimet?

Projektbuxheti mbështetet në parashikimin se ekonomia e Kosovës do të rritet për 4.2 për qind gjatë vitit 2027. Sipas projeksioneve qeveritare, vlera e përgjithshme e ekonomisë pritet të arrijë në rreth 14 miliardë euro krahasuar me rreth 13 miliardë sa vlerësohet për vitin 2026.

Konsumi privat, investimet dhe eksportet e shërbimeve, pritet të jenë ndër faktorët kryesorë të rritjes. Por, çmimet mbeten një nga shqetësimet kryesore për qytetarët.

Në shtator të këtij viti inflacioni vjetor arriti në 7.8 për qind, sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës.

Qeveria parashikon që inflacioni të ngadalësohet në 4 për qind gjatë vitit 2027. Kjo nuk do të thotë se çmimet do të ulen, por se pritet të rriten me ritëm më të ngadalshëm.

Në projektbuxhet, megjithatë, paralajmërohet se këto pritje mund të ndikohen nga shtrenjtimi i produkteve në tregjet ndërkombëtare, ngadalësimi ekonomik i vendeve partnere dhe zhvillimet në sektorin energjetik.

Kur pritet të miratohet buxheti?

Qeveria e Kosovës e miratoi projektbuxhetin më 2 nëntor, pas afatit të 31 tetorit të përcaktuar për dorëzimin e tij në Kuvend.

Deputetja e Lidhjes Demokratike të Kosovës, Hykmete Bajrami, e kritikoi qeverinë për mosrespektimin e këtij afati.

Ministri Murati, ndërkaq, tha se afati ishte respektuar, pasi 31 tetori kishte qenë ditë e shtunë.

Projektligji tani duhet të shqyrtohet dhe të votohet nga Kuvendi në dy lexime, deri në fund të vitit. Gjatë këtij procesi deputetët mund të propozojnë ndryshime në ndarjet buxhetore.

GUVERNATORI ISMAILI I INFORMON PËRFAQËSUESIT DIPLOMATIKË PËR ZHVILLIMET NË SEKTORIN FINANCIAR

PRISHTINË, 4 NËNTOR - Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), Ahmet Ismaili, i shoqëruar nga zëvendës-guvernatorët, zhvilloi një takim informues me shefat dhe përfaqësuesit e misioneve diplomatike në Kosovë, si dhe përfaqësues të institucioneve evropiane dhe financiare ndërkombëtare.

Gjatë takimit guvernatori paraqiti zhvillimet makroekonomike dhe në sektorin financiar, qëndrueshmërinë e sistemit bankar dhe përparimin e reformave institucionale. Ai theksoi se treguesit e kapitalizimit, likuiditetit dhe cilësisë së kredive konfirmojnë qëndrueshmërinë e sektorit bankar, ndërsa BQK-ja po avancon reformat në mbikëqyrjen e bazuar në rrezik, kornizën makroprudenciale, mbrojtjen e konsumatorëve dhe përafrimin rregullativ me standardet e Bashkimit Evropian. Integrimi financiar evropian mbetet prioritet strategjik i BQK-së, me fokus të veçantë në finalizimin e aplikimit të Kosovës për anëtarësim në SEPA dhe zhvillimin e sistemit TIPS-K për pagesa të shpejta, në bashkëpunim me Bankën e Italisë.



Këto iniciativa synojnë modernizimin e infrastrukturës së pagesave, uljen e kostove të transaksioneve dhe forcimin e ndërlidhjes financiare të Kosovës me Evropën. "Stabiliteti financiar, reformat institucionale dhe integrimi evropian janë prioritete që përforcojnë njëratjetrën. Objektivi ynë është që përafrimi me standardet evropiane të përkthehet në përfitime konkrete për qytetarët, bizneset dhe ekonominë", theksoi guvernatori Ismaili.

Guvernatori shprehu mirënjohje për përfaqësuesit diplomatikë, institucionet evropiane, bankat qendrore partnere dhe institucionet financiare ndërkombëtare për bashkëpunimin e vazhdueshëm dhe asistencën teknike në mbështetje të reformave të BQK-së, duke riafirmuar përkushtimin për forcimin e partneriteteve dhe avancimin e integrimit financiar evropian.

GUVERNATORI ISMAILI TAKON KURTIN: NË FOKUS PËRGATITJET PËRFUNDIMTARE PËR APLIKIM NË SEPA DHE REFORMAT NË SEKTORIN FINANCIAR

PRISHTINË, 4 NËNTOR - Në kuadër të takimeve dhe konsultimeve me institucionet vendore dhe partnerët përkatës për finalizimin e përgatitjeve për aplikimin e Kosovës në Zonën e Vetme të Pagesave në Euro (SEPA), guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), Ahmet Ismaili, zhvilloi një takim pune me kryeministrin Albin Kurti.

Gjatë takimit guvernatori Ismaili e informoi kryeministrin për zhvillimet e fundit në sektorin financiar, treguesit e qëndrueshmërisë së sektorit bankar dhe përparimin e reformave që BQK po zbaton në kuadër të mandatit të saj, me fokus në forcimin e mbikëqyrjes financiare, modernizimin e infrastrukturës financiare dhe përafrimin e kornizës rregullative me standardet e Bashkimit Evropian.



Vëmendje e veçantë iu kushtua përparimit në procesin e aplikimit në SEPA, përfshirë përmbushjen e kritereve përkatëse dhe hapat e mbetur për dorëzimin e aplikimit formal pranë Këshillit Evropian të Pagesave (EPC). Në këtë kontekst, guvernatori Ismaili vlerësoi miratimin e ndryshimeve në legjislacionin për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit (PPP/LFT), si një zhvillim i rëndësishëm për avancimin e këtij procesi.

Në takim u diskutua edhe për agjendën legjislative dhe rregullative që synon avancimin e reformave strukturore në sektorin financiar, përfshirë ato që ndërlidhen me angazhimet e Kosovës në kuadër të Planit të Rritjes së BE-së për Ballkanin Perëndimor.

U theksua rëndësia e koordinimit ndërinstitucional për zbatimin e këtyre reformave dhe përafrimin e mëtejshëm me legjislacionin evropian.

Në kuadër të modernizimit të sistemeve të pagesave, guvernatori e informoi kryeministrin edhe për përparimin në zhvillimin e sistemit të pagesave të shpejta (TIPS Clone).

U theksua se avancimi i këtij projekti, së bashku me integrimin në SEPA, do të kontribuojë në rritjen e efikasitetit të pagesave, uljen e kostove të transaksioneve dhe zgjerimin e mundësive për qytetarët dhe bizneset, duke mbështetur integrimin financiar dhe ekonomik të Kosovës me Bashkimin Evropian.

Guvernatori Ismaili shprehu mirënjohjen për bashkëpunimin dhe mbështetjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës për avancimin e agjendës së reformave ligjore dhe institucionale, veçanërisht në proceset që kërkojnë angazhim dhe koordinim ndërinstitucional.

Në përfundim u riafirmua përkushtimi për vazhdimin e bashkëpunimit për realizimin e prioriteteve strategjike për stabilitetin financiar, modernizimin e sektorit financiar dhe integrimin evropian, në respektim të plotë të mandatit dhe pavarësisë institucionale të BQK-së.

KRYETARI I AKB-SË, SHAHINI: BUXHET I MADH, ZHVILLIM I PAMJAFTUESHËM

PRISHTINË, 4 NËNTOR - Aleanca Kosovare e Bizneseve (AKB), pas analizimit të Projektbuxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2027, ka shprehur shqetësimin se struktura e propozuar buxhetore nuk po i jep peshën e duhur zhvillimit të sektorit privat, prodhimit vendor, eksporteve dhe investimeve të reja. "Projektbuxheti prej rreth 4.27 miliardë eurosh paraqitet si buxhet rekord, por madhësia e tij nuk është dëshmi e zhvillimit ekonomik. Ajo që ka rëndësi është se sa nga këto mjete krijojnë vlerë të re ekonomike, rrisin prodhimin, fuqizojnë bizneset dhe krijojnë vende të qëndrueshme pune", ka thënë kryetari i Aleancës Kosovare të Bizneseve, Agim Shahini.

AKB-ja vlerëson se orientimi i madh drejt shpenzimeve për paga, subvencione dhe transfere, pa një program të fuqishëm zhvillimor për bizneset, nuk garanton qëndrueshmëri afatgjatë ekonomike. "Shqetësues është edhe zvogëlimi i planifikuar i buxhetit të Ministrisë së Ekonomisë nga rreth 79 milionë euro në 23.4 milionë euro. Në kohën kur bizneset kanë nevojë për energji më të përballueshme, investime industriale dhe mbështetje për konkurrueshmëri, ky ndryshim kërkon sqarim të plotë nga institucionet përgjegjëse. Po ashtu, realizimi prej vetëm 37 për qind i investimeve kapitale gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2026 dëshmon se problemi i Kosovës nuk është vetëm ndarja e mjeteve buxhetore, por edhe aftësia institucionale për t'i realizuar ato", ka thënë ai.

AKB-ja kërkon që gjatë shqyrtimit dhe miratimit të Buxhetit 2027 të përfshihen këto prioritete: 1. Krijimi i një fondi zhvillimor për prodhimin vendor dhe ndërmarrjet prodhuese. 2. Mbështetje më e madhe financiare për eksportuesit dhe



produktet Madie in Kosova. 3. Lehtësime fiskale dhe stimuj për investimet e reja private dhe industriale. 4. Masa konkrete për uljen e kostos së energjisë dhe rritjen e sigurisë energjetike për bizneset. 5. Rritja e realizimit të investimeve kapitale, me përgjegjësi dhe afate konkrete. 6. Mbështetje më e fuqishme për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, si shtylla kryesore e punësimit dhe zhvillimit ekonomik.

Shahini ka thënë se AKB-ja nuk e kundërshton rritjen e pagave, pensioneve dhe mbështetjes sociale, por thekson se këto politika duhet të mbështeten në një ekonomi prodhuese dhe në një sektor privat të fuqishëm. "Nuk mund të kërkohet vazhdimisht më shumë nga bizneset, ndërkohë që nuk krijohen kushte të mjaftueshme për prodhim, investime dhe konkurrueshmëri. Biznesi nuk duhet të shihet vetëm si burim i të hyrave buxhetore, por si partner strategjik i shtetit në zhvillimin ekonomik. Kosova nuk mund të mbështetet pafundësisht në konsum, importe dhe të hyra doganore, ndërkohë që prodhimi vendor mbetet i pamjaftueshëm dhe deficiti tregtar vazhdon të jetë një nga sfidat kryesore të ekonomisë", ka thënë ai.

Shahini ka shtuar se AKB-ja i bën thirrje Qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës që Buxhetin 2027 ta kthejnë nga një buxhet i shpenzimeve, në një buxhet të zhvillimit ekonomik. "Kosovës i duhet buxhet edhe më i madh se 4.27 miliardë eurosh. Por Kosovës i duhet më shumë prodhim, më shumë eksporte, më shumë investime dhe më shumë vende pune", ka deklaruar Shahini.

ÇFARË DO TË THOTË HUMBJA E TRUMPIT PËR EVROPËN? ÇFARË DO TË NDODHË ME EURON DHE TREGJET GLOBALE?



Demokratët kanë fituar kontrollin e të dyja dhomave të Kongresit amerikan. Për Europën, çështjet kryesore mbeten tarifat tregtare dhe Ukraina, fusha në të cilat Trump vazhdon të ketë kompetenca të konsiderueshme.

Donald Trump ka pësuar një nga humbjet më të mëdha të karrierës së tij politike, pasi republikanët humbën kontrollin e të dyja dhomave të Kongresit përballë demokratëve, në zgjedhje që u shndërruan në një referendum për presidencën e tij.

Deri mëngjesin e sotëm, demokratët kishin fituar 25 vende në Dhomën e Përfaqësuesve, duke arritur në 220 mandate, dy më shumë se 218 vendet e nevojshme për shumicën.

Në Senat, ata iu morën republikanëve shtatë vende, përfshirë në Teksas, Ohajo, Kansas dhe Mein.

Çmimet e larta ndikuan ndjeshëm në vendimin e votuesve. Rreth dy të tretat e të anketuarve në ditën e zgjedhjeve deklaruan se tarifat tregtare të Trump kishin dëmtuar ekonominë.

Presidenti deklaroi se do t'i pranonte rezultatet, por shtoi: "Nuk e konsideroj këtë si një goditje ndaj meje".

Ai e bëri gjithashtu të qartë se do të përdorte veton presidenciale për të bllokuar agjendën e demokratëve, duke publikuar fotografinë e një kapeleje të kuqe me fjalën "VETO" të qëndisur mbi të.

Por sa mund të ndryshojë realisht një Kongres i kontrolluar nga demokratët për Europën dhe tregjet financiare?

A do t'i japë fund Kongresi demokrat kërcënimit të tarifave ndaj Europës?

Me shumë mundësi jo, sepse tarifat e Trump nuk varen më nga Kongresi.

Pasi Gjykata e Lartë rrëzoi në shkurt tarifat e vendosura prej tij duke përdorur kompetencat e emergjencës, administrata amerikane i kaloi ato nën Seksionin 301 të legjislacionit tregtar amerikan. Kjo dispozitë i mundëson presidentit të veprojë pa pasur nevojë për votim nga ligjvënësit.

Demokratët mund të zhvillojnë seanca dëgjimore dhe të ngadalësojnë miratimin e kandidatëve të propozuar nga presidenti për poste të rëndësishme, por nuk mund t'ia heqin lehtësisht këtë kompetencë.

James Smith, ekonomist për tregjet në bankën holandeze ING, beson se ndarja e pushtetit në Uashington mund ta shtyjë presidentin të mbështetet edhe më shumë te këto kompetenca.

"Ashtu si politika e jashtme, edhe tregtia është një tjetër fushë ku presidenti mund të ushtrojë pushtet në mënyrë të njëanshme, pa Kongresin", deklaroi Smith në një analizë të publikuar përpara zgjedhjeve.

Ai nuk përjashtoi mundësinë e vendosjes së tarifave të reja ndaj Europës, të cilat, sipas tij, do të kishin ndikim të rëndësishëm mbi inflacionin amerikan dhe mbi politikën e Rezervës Federale.

Çfarë do të ndodhë me mbështetjen amerikane për Ukrainën?

Demokratët do të marrin drejtimin e komisioneve të Senatit dhe do të vendosin se cilët prej kandidatëve të propozuar nga Trump për poste të rëndësishme do të konfirmohen, kur Kongresi i ri të marrë detyrën në janar.

Shumë prej tyre dëshirojnë gjithashtu të miratojnë fonde të reja për Ukrainën.

Por pjesa më e vështirë është të sigurohet që këto fonde të shpenzohen realisht.

Gjatë dy viteve të fundit, Shtëpia e Bardhë ka anuluar në praktikë fonde të miratuara më parë nga Kongresi, duke e vonuar përdorimin e tyre deri në fund të vitit fiskal, kur fondet skadojnë.

"Në praktikë, kjo do të thotë se një Kongres demokrat mund të përfshijë në ligj fonde për Ukrainën apo ndihmën për zhvillim, por presidenti mund të mos i shpenzojë ato", deklaroi Nevada Joan Lee, eksperte e politikave në Këshillin Europian për Marrëdhëniet me Jashtë (ECFR), në një koment të publikuar muajin e kaluar.

Këshilla e saj për qeveritë europiane është të mbështeten vetëm te fondet që disbursohen realisht.

"Europianët duhet t'i konsiderojnë fondet e parashikuara si shprehje të një synimi, jo si angazhim të garantuar", tha Lee.

Investitorët reaguan përgjithësisht me qetësi.

Euro u forcua me 0.4%, duke arritur në 1.1232 dollarë deri në orën 07:00, sipas kohës së Europës Qendrore, ndërsa dollari amerikan u dobësua kundrejt monedhave të tjera kryesore.

Ari u rrit me 2%, duke arritur në 4,011 dollarë për onz, dhe u rikthye mbi kufirin e 4,000 dollarëve, ndërsa argjendi u shtrenjtua me 3.4%, në 51.49 dollarë për onz.

Kontratat e së ardhmes për aksionet shënuan rënie të lehta në të dyja anët e Atlantikut.

Kontratat e së ardhmes për indeksin S&P 500 ranë me 0.3%, ndërsa ato për Nasdaq 100 me 0.4%. Në Europë, kontratat për Euro Stoxx 50 dhe indeksin gjerman DAX ishin në rënie me rreth 0.5%, përpara hapjes së tregjeve.

Obligacionet e qeverisë amerikane u forcuan.

Norma e interesit të obligacioneve dhjetëvjeçare të Thesarit amerikan ra me 2.9 pikë bazë, në 4.94%, ndërsa yield-i i obligacioneve dyvjeçare zbriti në 4.61% dhe ai i obligacioneve tridhjetëvjeçare në 5.32%.

Në Gjermani, yield-i i obligacioneve dhjetëvjeçare të qeverisë, të njohura si Bund, ishte mbyllur të martën në 3.33%, përpara publikimit të rezultateve të zgjedhjeve.

Bitcoin mbeti pothuajse i pandryshuar, në rreth 77,700 dollarë, ndërsa nafta Brent tregtohej pranë nivelit 104 dollarë për fuçi.

A është një Uashington me pushtet të ndarë i favorshëm për investitorët?

Historikisht, tregjet e kanë mirëpritur një situatë të tillë. Kur Shtëpia e Bardhë dhe Kongresi nuk bien dakord, miratohen më pak ligje me ndikim të madh dhe, për pasojë, ka më pak surpriza për investitorët.

Përvoja historike favorizon gjithashtu investitorët në obligacione.

Sipas Luca Bindelli, drejtues i strategjisë së investimeve në bankën private zvicerane Lombard Odier, gjatë tre muajve pas zgjedhjeve të mëparshme të mesmandatit, yield-et e obligacioneve dhjetëvjeçare të Thesarit amerikan kanë rënë mesatarisht me rreth 20-25 pikë bazë.

"Ne mendojmë se një fitore e plotë e demokratëve do të ishte neutrale ose lehtësisht pozitive për perspektivën fiskale. Kongresi mund të kufizojë agjendën ekspansioniste të Trump dhe, bashkë me të, edhe deficitin buxhetor", deklaroi Diego Barnuevo, analist tregjesh në kompaninë e pagesave Ebury, në komentet e dërguara me email.

Ed Yardeni, president i Yardeni Research, është më i kujdesshëm.

"Wall Street tradicionalisht e mirëpret bllokimin politik, sepse ai zvogëlon mundësinë që Kongresi të miratojë legjislacion ekstrem. Por këtë herë mund të jetë ndryshe", shkroi Yardeni në një analizë të publikuar të hënën.

Shqetësimi i tij lidhet me tavanin e borxhit, kufirin ligjor që përcakton shumën që qeveria amerikane mund të marrë hua.

Një Uashington me pushtet të ndarë do të duhet sërish të arrijë marrëveshje për rritjen e këtij tavani. Një përplasje e zgjatur politike mbi këtë çështje mund t'i rrisë kostot e huamarrjes, në vend që t'i ulë ato.

Barnuevo pret që tavani i borxhit të bëhet një kufizim real në një moment gjatë vitit 2027.

Çfarë pritet të ndodhë me euron?

Analistët e tregjeve valutore dyshojnë se rezultati i zgjedhjeve do të sjellë ndryshime afatgjata.

Për dollarin amerikan, politika monetare e Rezervës Federale vazhdon të ketë ndikim më të madh sesa përbërja politike e Kongresit.

"Dollari vazhdon të reagojë kryesisht ndaj zhvillimeve që lidhen me Rezervën Federale, të cilat nuk pritet të ndikohen menjëherë dhe drejtpërdrejt nga rezultati i zgjedhjeve të mesmandatit", deklaruan Francesco Pesole, strateg i tregut valutor në ING, dhe kolegët e tij në një analizë të publikuar të martën.

Edhe euro përballet me problemet e veta.

Çmimet e energjisë mbeten të larta, kryesisht për shkak të luftës me Iranin. ING parashikon që inflacioni në Eurozonë të qëndrojë pranë nivelit 4%, ndërsa investitorët po kërkojnë norma më të larta interesi për të mbajtur obligacionet e qeverisë franceze.

Kongresi i ri do të marrë detyrën në janar.

Deri atëherë, Trump do të vazhdojë të ketë shumicën republikane në të dyja dhomat. Edhe pasi demokratët të marrin kontrollin e Kongresit, presidenti do ta ketë ende në dispozicion të drejtën e vetos. /euronews

GREQIA SHEH DRITËN E RIMËKËMBJES DUKE TËRHEQUR MILIONERËT

Nga miliarderët e fondeve të investimeve që kërkojnë që Greqia të kthehet në rezidencën e tyre fiskale, te pensionistët e pasur që e zgjedhin si vendin ideal për të kaluar vitet e pleqërisë. Athina po përpiqet të ringrihet ekonomikisht duke tërhequr kapital dhe banorë të rinj. Por për një rimëkëmbje të qëndrueshme nevojitet shumë më tepër.

Le ta kujtojmë: në vitin 2015, Greqia ndodhej sërish në prag të falimentimit financiar dhe rreziku i një daljeje nga eurozona, i njohur si Grexit, dukej krejtësisht real.

Njëmbëdhjetë vjet më vonë, panorama ka ndryshuar. Ekonomia po rritet, financat publike po përmirësohen dhe vendi po tërheq kapital, biznese dhe banorë të rinj.

Bëri bujë lajmi se Chris Rokos, themeluesi i fondit spekulativ të investimeve Rokos Capital Management, ka zgjedhur Greqinë si rezidencën e tij fiskale dhe po përgatitet të hapë një zyrë në zemër të Athinës.

Menjëherë më pas erdhi një tjetër lajm: edhe Israel Englander, themeluesi i Millennium Management, synon të vendosë praninë e tij në kryeqytetin grek. Këto janë dy sinjale të ambicies së Greqisë për të tërhequr jo vetëm pasuri të mëdha private, por edhe aktivitete financiare ndërkombëtare.

Dhe interesi shkon përtej botës së financës. Kampioni i tenisit Novak Djokovic është vendosur në Athinë së bashku me familjen e tij.

Në fushën e investimeve, irlandezi Paul Coulson, aksionari kryesor i Ardagh Group, ka vënë bast mbi Peloponezin, duke blerë struktura hoteliere dhe toka në zonën e Porto Helit.

Ndërkohë, grupi i Richard Hsiao ka blerë klubin e basketbollit Aris të Selanikut.

Janë të tjera shenja të një fuqie tërheqëse që shkon përtej lehtësive të ofruara nga qeveria.

Greqia, taksa të favorshme për të pasurit dhe profesionistët e financës

Në vitin 2020, Greqia prezantoi një regjim fiskal të lehtësuar për të tërhequr banorë të rinj me pasuri të mëdha. Neni 5A parashikon një taksë fikse vjetore prej 100 mijë eurosh mbi të ardhurat e krijuara jashtë vendit, për një periudhë maksimale prej 15 vjetësh.

Për të përfituar nga kjo skemë, personi nuk duhet të ketë qenë rezident fiskal në Greqi për të paktën shtatë nga tetë vitet e mëparshme dhe duhet të investojë në vend të paktën 500 mijë euro.

Për pensionistët e huaj është parashikuar një regjim i veçantë.

Në vitin 2026, qeveria prezantoi gjithashtu një normë tatimore prej 5% mbi carried interest, pjesën e fitimeve të një fondi investimesh që u jepet



menaxherëve si shpërblim për performancën.

Kjo masë zbatohet për kategori të caktuara profesionistësh të financës, me lehtësi që mund të zgjasin deri në shtatë vjet dhe me kushte të posaçme lidhur me shpenzimet që punëdhënësi duhet të kryejë në territorin grek.

Një ekonomi që po rimëkëmbet, por ende mbart plagët e krizës

"Vendi ka kaluar një nga periudhat më të vështira të historisë së tij dhe, pothuajse 20 vjet pas krizës financiare globale, ende nuk e ka ngushtuar plotësisht hendekun me partnerët e tjerë europianë. Kostot sociale dhe ekonomike kanë qenë jashtëzakonisht të larta. Vetëm kohët e fundit qytetarët kanë filluar të ndiejnë përfitime konkrete nga rimëkëmbja". Kështu shprehet për Panorama Lorenzo Codogno, profesor i ftuar në praktikën profesionale pranë Institutit Europian të London School of Economics (LSE), si dhe themelues e kryeekonomist i LC Macro Advisors.

Në vitin 2025, Prodhimi i Brendshëm Bruto i Greqisë u rrit me 2,1%, ndërsa raporti i borxhit publik ndaj PBB-së zbriti në 146,1%, sipas Eurostat.

Për vitin 2026, Komisioni Europian parashikon një rritje ekonomike prej 1,8% dhe një ulje të mëtejshme të borxhit publik në 140,7% të PBB-së.

Megjithatë, deficiti mbetet më i larti në Bashkimin Europian, ndërsa deficiti i llogarive rrjedhëse përbën një dobësi strukturore të ekonomisë.

Reformat e dhimbshme që ndryshuan fatin e Greqisë

Për të kuptuar sa shumë ka ndryshuar situata që nga viti 2015, nuk mjafton të shohim vetëm bilancet financiare.

Theodore Pelagidis, ekonomist dhe profesor në Universitetin e Pireut, i cili ka mbajtur postin e zëvendësguvernatorit të Bankës së Greqisë deri në shtator 2026, e identifikon pikën e kthesës te reformat e imponuara nga kreditorët dhe ristrukturimi i borxhit.

Ky i fundit vazhdon të jetë i lartë, por përfiton nga afate të gjata shlyerjeje dhe kushte të favorshme financimi. "Ekonomia vazhdon të vuajë nga produktiviteti i ulët", shpjegon Pelagidis, "çka kufizon edhe rritjen e pagave".

Kësaj i shtohet "rënia demografike", e cila zvogëlon fuqinë punëtore dhe aktivitetin ekonomik.

Probleme të tjera lidhen me "qëndrueshmërinë e institucioneve dhe meritokracinë", dobësi që, sipas ekonomistit, e kanë shoqëruar Greqinë që nga krijimi i shtetit modern.

Kriza demografike, një nga pengesat më të mëdha

Stimujt fiskalë mund ta bëjnë Athinën më konkurruese dhe ta vendosin vendin në të njëjtën rrugë me shtete të tjera, si Portugalia.

Por ata nuk mund të zëvendësojnë investimet prodhuese. "Vetëm duke rritur produktivitetin", vëren Pelagidis, "mund të rriten të ardhurat dhe standardi i jetesës së grekëve".

Banorët e rinj mund të mbështesin konsumin dhe rritjen ekonomike në një vend që përballet me tkurrje demografike. Megjithatë, kërkesa e re nuk duhet të përqendrohet në zonat që janë tashmë më të shtrenjta dhe më të mbipopulluara.

"Sfida është të tërheqim njerëz drejt rajoneve rurale, ku cilësia e jetës mund të jetë e lartë dhe ku nuk ka mungesë banesash".

A mund të bëhet Greqia një model ekonomik për Europën?

Duke analizuar financat publike dhe qëndrueshmërinë e përgjithshme të ekonomisë, Codogno këshillon kujdes.

"Megjithëse ekonomia po rritet me ritme të qëndrueshme dhe papunësia ndodhet në nivelet më të ulëta historike, deficiti i llogarisë korrente mbetet i lartë. Gjithashtu, ulja e kredive me probleme jashtë sektorit bankar po ecën ende ngadalë. Për këtë arsye, nuk do ta quaja Greqinë një model për Europën, por sigurisht një shembull domethënës të reformimit të një vendi që preku fundin dhe arriti të ringrihej, edhe falë Europës.

Ulja e evazionit fiskal duket se ka marrë karakter strukturor, ashtu si edhe suficiti primar i financave publike. Me shumë gjasë, do të vazhdojë edhe ulja e raportit të borxhit publik ndaj PBB-së".

Por sa mund të ndikojë realisht strategjia për tërheqjen e rezidentëve të pasur?

"Në nivelin e saj kufitar, ajo mund të jetë domethënëse, por nuk besoj se do të ketë ndikim të madh në rritjen ekonomike apo në financat publike. Është një formë konkurrence fiskale më e favorshme në Europë, ndoshta e shoqëruar edhe me pak diell dhe det".

Pas ndryshimeve fiskale në Britani, të pasurit kërkojnë destinacione të reja

Referimi ndaj Mbretërisë së Bashkuar është i pashmangshëm. Heqja e regjimit të njohur si non-dom zëvendësoi sistemin që bazohej te vendbanimi i përhershëm juridik me një sistem të mbështetur te rezidenca fiskale dhe rregulla të reja për pasuritë jashtë vendit.

"Ky regjim favorizonte pozicionin fiskal të disa personave që kalonin një pjesë të vitit jashtë vendit. Qytetarët e konsideronin të padrejtë. Shumë nga lehtësitë janë hequr dhe mendoj se kjo është pozitive", vëren Codogno.

Tregu i pasurive të paluajtshme po tërheq gjithnjë e më shumë të huaj

Fenomeni është i dukshëm edhe në tregun e pasurive të paluajtshme.

"Vitet e fundit është rritur përqindja e blerësve të huaj që dëshirojnë të vendosen përgjithmonë në territorin grek", shpjegon Giorgos Gavriilidis, themelues dhe drejtor ekzekutiv i Elxis – At Home in Greece, kompani e specializuar në pasuri të paluajtshme.

"Sipas një studimi tonë të fundit, 30,8% e personave që na kanë kontaktuar këtë vit kërkojnë një banesë të përhershme. Në shumicën e rasteve bëhet fjalë për pensionistë. Shtëpitë e pushimit vazhdojnë të përfaqësojnë segmentin kryesor, me 44,4%, ndërsa 17,8% blejnë kryesisht për qëllime investimi.

Tregu vazhdon të mbështetet kryesisht te shtresa e mesme dhe ajo e mesme e lartë. Së bashku me Shtetet e Bashkuara, Mbretëria e Bashkuar është tregu ynë kryesor jashtë Bashkimit Europian. Klientët tanë blejnë kryesisht për arsye që lidhen me stilin e jetesës dhe jo për motive fiskale".

Skema e njohur si Golden Visa, që mundëson marrjen e lejes së qëndrimit përmes investimeve, duket se ka një ndikim më të kufizuar.

Vetëm 7% e klientëve e përmendin atë si arsyen kryesore të blerjes.

A po shndërrohet Greqia në parajsën e re të të pasurve europianë?

Mundësia që Greqia të bëhet një destinacion i ri për pasuritë e mëdha europiane duhet vlerësuar me kujdes.

"Nuk mund ta them me siguri, por mua më duket se ky fenomen po mbivlerësohet. Ndoshta është veçanërisht i dukshëm në këtë moment edhe për shkak të largimit të personave me të ardhura të larta nga Emiratet e Bashkuara Arabe, pas tensioneve ushtarake në Gjirin Persik", vijon Codogno.

"Edhe tërheqja e individëve me të ardhura të larta mund të sjellë disa përfitime, megjithëse ato kompensohen pjesërisht nga kosto dhe pabarazi sociale. Megjithatë, ardhja e disa pensionistëve të pasur më shumë apo më pak nuk e ndryshon gjendjen strukturore të një vendi. Ndryshe ndodh me tërheqjen e investimeve prodhuese, veçanërisht të investimeve të huaja direkte, përmes të cilave një kompani krijon nga e para një aktivitet të ri ose një strukturë prodhuese. Këto investime krijojnë potencial për rritjen ekonomike të së ardhmes".

Taksa të ulëta nuk mjaftojnë për të ndërtuar një ekonomi të fortë

Vetëm përdorimi i politikës fiskale nuk është i mjaftueshëm.

"Gjithçka varet edhe nga aftësia për të krijuar një mjedis të favorshëm për sipërmarrjen, inovacionin dhe rritjen ekonomike. Në këtë drejtim, Greqia, por edhe Italia, kanë ende shumë punë për të bërë", thekson Codogno.

Sfida e vërtetë është shndërrimi i fluksit të kapitalit në produktivitet ekonomik.

Nëse ky kapital do të mbetet i përqendruar te pasuritë e paluajtshme dhe konsumi, Greqia thjesht do të ketë gjetur një mënyrë të re për të përfituar financiarisht nga tërheqja që ushtron si destinacion.

Por nëse arrin ta shndërrojë atë në investime, aftësi profesionale dhe vende pune, gara për të tërhequr të pasurit mund të bëhet diçka shumë më e rëndësishme sesa një konkurrencë mes vendeve për taksa më të ulëta.

Sepse rimëkëmbja e vërtetë e Greqisë nuk do të matet me numrin e milionerëve që vendosen në Athinë, por me aftësinë për ta kthyer pasurinë e tyre në zhvillim ekonomik dhe mirëqenie për qytetarët grekë. / Ludovica Amici, Panorama Italia



sport

QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Prishtina mposht Dritën, merr kreun e Superligës



GJILAN, 4 NËNTOR - Prishtina ka mposhtur Dritën me rezultat 2:1 në ndeshjen e mbetur të xhiros së dytë të Superligës së Kosovës në futboll. Në përballjen e zhvilluar të mërkurën në Gjilan, kryeqytetasit i kanë shkaktuar Dritës humbjen e parë pas një serie prej katër fitoresh radhazi. Me këtë fitore Prishtina ka marrë kreun e tabelës me 29 pikë, duke lënë pas Malishevën me 27 dhe Dritën, që renditet e treta me 23 pikë.

Blend Baftiu dhe Ardian Hasani kanë shënuar golat e fitores për Prishtinën, e cila para dhjetë ditësh ishte mposhtur 3:0 nga Drita në kuadër të xhiros së 11-të.

Baftiu ka kaluar Prishtinën në epërsi në minutën e shtatë, ndërsa Blerim Krasniqi ka barazuar për Dritën në minutën e 19. Golin e fitores për mysafirët e ka shënuar Hasani në minutën e 59. Në xhiron e 13-të, që zhvillohet këtë fundjavë, Prishtina do të jetë mysafire e Vushtrrisë, ndërsa Drita do të përballet me Drenicën në Skenderaj.

KOSOVA MËSON KUNDËRSHTARET NË EDICIONIN E RI TË LIGËS SË KOMBEVE



NION, 4 NËNTOR - Kombëtarja e Kosovës në konkurrencën e femrave ka mësuar kundërshtaret për edicionin e ri të UEFA Ligës së Kombeve.

"Dardanet" do të garojnë në Ligën B, ndërsa shorti i hedhur të martën në selinë e UEFA-s në Nion i ka vendosur në Grupin B4, së bashku me Sllovenínë, Turqinë dhe Hungarinë. Në ceremoninë e tërheqjes së shortit, Federata e Futbollit e Kosovës është përfaqësuar nga shefja e futbollit të femrave, Valbona Gashi Uka, dhe përzgjedhësja e Kombëtares, Sanije Krasniqi.

Kjo e fundit e ka vlerësuar shortin si të favorshëm, duke theksuar se Kosova është rritur si ekip dhe ka potencial për të arritur rezultate pozitive. "Pa dyshim që Liga B është një nivel më i lartë se Liga C, por besoj se edhe ne jemi rritur si ekip dhe kemi potencial të mirë. Duke pasur parasysh kundërshtaret e mundshëm, mendoj se kemi pasur një short të favorshëm. Tani na mbetet që të përgatitemi me përkushtim dhe do të mundohemi të arrijmë rezultate pozitive në çdo ndeshje", ka thënë Krasniqi.

Në edicionin e ri, Liga A dhe Liga B do të përbëhen nga 16 kombëtare secila, ndërsa 22 kombëtaret e tjera do të garojnë në Ligën C. Liga A dhe Liga B do të ndahen nga katër grupe me nga katër skuadra. Ndërkaq Liga C do të përbëhet nga gjashtë grupe, katër prej të cilave me nga katër skuadra dhe dy me nga tri skuadra. Ndeshjet e xhiros së parë dhe të dytë të fazës së grupeve do të zhvillohen nga 23 shkurti deri më 6 mars 2027. Ndeshjet e xhiros së tretë dhe të katërt janë paraparë për periudhën 13-24 prill, ndërsa dy xhirot e fundit të fazës së grupeve do të luhen nga 7 deri më 15 qershor 2027.

ATLETICO MADRIDI INTERESOHET PËR LEON AVDULLAHUN



MADRID, 4 NËNTOR - Mesfushori i Kombëtares së Kosovës, Leon Avdullahu, mund ta bëjë një hap të madh në karrierë gjatë verës së vitit të ardhshëm. Skuadra e La Ligës, Atletico Madridi, ka shprehur interesim për mesfushorin e Hoffenheimit, ka raportuar sajti "Fussball Transfers". Sipas mediumit të specializuar për transferime, trajneri i Atleticos, Diego Simeone, u ka kërkuar drejtuesve të klubit t'i nisin negociatat me Hoffenheimin për transferimin e Avdullahut. "Në verë kishte disa skuadra spanjolle të interesuara. Megjithatë, Hoffenheimi e bllokoi transferimin, pasi ishte i vendosur ta mbante Avdullahun të paktën edhe një vit tjetër. Mesfushori është lojtar kyç te Hoffenheimi, i cili në vitin 2025 e bleu për tetë milionë euro nga Baseli", shkruan mediumi gjerman. Avdullahu, 22 vjeç, ka kontratë me Hoffenheimin deri në vitin 2031. Në sezonin aktual ai ka shënuar një gol në 13 paraqitje në të gjitha garat.

LAMINE YAMAL THYEN REKORDIN E MBAPPES NË LIGËN E KAMPIONËVE



BARCELONË, 4 NËNTOR - Lamine Yamal vazhdon të shkruajë histori në Ligën e Kampionëve. Ylli i Barcelonës ka thyer një rekord të Kylian Mbappes, duke regjistruar më shumë gola në këtë garë para se të mbushte 20 vjeç. Në moshën 19-vjeçare Yamal ka arritur në kuotën e 14 golave në Ligën e Kampionëve, një më shumë se Mbappé, i cili kishte realizuar 13 gola para ditëlindjes së tij të 20, shkruan Barcelona në faqen zyrtare. Yamal e ka arritur këtë shifër në vetëm 37 paraqitje në kompeticionin më prestigjioz për klube. Në fitoren 3:0 ndaj Aston Villas, futbollisti spanjoll ka shënuar golin e parë të ndeshjes në minutën e shtatë, duke përfituar nga një gabim i mbrojtjes kundërshtare. Yamal do të ketë ende kohë për ta përmirësuar rekordin, pasi ditëlindjen e 20 do ta festojë në korrik të vitit të ardhshëm.

Haaland mund të largohet nga City



MANCHESTER, 4 NËNTOR - E ardhmja e Erling Haalandit te Manchester City mund të varet edhe nga vendimi përfundimtar lidhur me çështjen e shkeljeve financiare të klubit anglez. Për këtë situatë ka folur edhe babai i sulmuesit norvegjez, Alf-Inge Haaland, i cili ka theksuar se fillimisht duhet pritur vendimi përfundimtar. "Po presim vendimin dhe më pas do të shohim se çfarë do të sjellë e ardhmja", ka thënë Alf-Inge, shkruan "Goal". Ai nuk e ka përjashtuar mundësinë që 26-vjeçari të largohet nga Manchester City, ku konsiderohet një prej lojtarëve kryesorë të skuadrës.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "BIFPRO TEK" SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 811379298 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "BIFPRO TEK" D.O.O. od Prishtinë, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811379298 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability "BIFPRO TEK" L.L.C. with headquarters Prishtinë, has come to the decision to quit its business: 811379298 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Leart Musolli" SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 811564302 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Leart Musolli" D.O.O. od Prishtinë, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811564302 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability "Leart Musolli" L.L.C. with headquarters Prishtinë, has come to the decision to quit its business: 811564302 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Zvogëlim i kapitalit nga firma EUROFAMIS Sh.A

Firma "EUROFAMIS" Sh.A, me numër UNIK IDENTIFIKUES, NUI: 811306431, me seli në Shirokë, Suharekë, bën zvogëlimin e kapitalit nga vlera 910.000,00 euro në vlerën 10.000,00 euro.

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Milazim Dana shpall te pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën QK "11 Marsi " Prizren.

- Shaban Kryeziu shpall te pavlefshme diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

- Driton Bucaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Abdyl Frasheri " Prizren.

- Armend Hoxhaj shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën Q K "11 Marsi " Prizren.

- Trim Rezniqi shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të sh.m.p "Gjon N. Kazazi" Gjakovë.

- Sokol Haxhikadrija shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Elidon Pylla B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 33049408.

- Elidon Pylla B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811149542 të lëshuar nga ARBK.

- Genti Kurhasku shpall të pavlefshme certifikatën e maturës shtetërore të sh.m. mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.

Duke u bazuar në nenin 7 të Udhëzimin Administrativ (MMPHI) Nr.01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në bashkëpunim me operatorin "AGI DANI" SH.P.K. Gjilan, kërkesa për vazhdim të Leje Mjedisore, me nr. prot. 26/5035/MMPH, për shfrytëzim të gurit gëqeror gëlqeror, Koretishtë, Novobërdë, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për kërkesën për t'u pajisur me Leje Mjedisore

Njoftohet publiku i interesuar se me datë: 26.11.2026, në ora: 10:00, në hapësirat e lokaleve të Kompanisë në Koretishtë, K. Novobërdë, do të organizohet debat publik nga operatori "AGI DANI" SH.P.K. Gjilan, kërkesa për vazhdim të Leje Mjedisore, me nr. prot. 25/5035/MMPH, për shfrytëzim të gurit gëqeror gëlqeror, Koretishtë, Novobërdë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM:

ID: 216 652 4738
Passcode: 123123

Join Zoom Meeting
https://us05web.zoom.us/j/2166524738?pwd=aJtauckjGTWwqBViElFDw68NDo3rzD.1

Në linkun e mëposhtëm, mund të gjeni aplikacionin e publikuar në ueb faqe të MMPH-së, për komente të publikut:

https://mmphi.rks-gov.net/Document?search=MATR

Pjesëmarrja e publikut është e mirëseardhur dhe e rëndësishme për procesin.

Me respekt,

"AGI DANI" SH.P.K.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "XHENI Make Up Artist" SH.P.K. me seli në Vushtrri, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812198316 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "XHENI Make Up Artist" D.O.O. sa sjedištem u Vushtrri, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812198316 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability "XHENI Make Up Artist" L.L.C., with headquarters Vushtrri, has come to the decision to quit its business: 812198316 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.




MEKA
HALAL FOOD
TRADITË QË NGA
1992
MEKA
HALAL FOOD
PASHTETË
PULE
GLUTEN FREE
100% MISH PULE
CILËSI E GARANTUAR
PA KONSERVUES